



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë **24.09.2014**, realizoi **vizitë të rregullt të paparalajmëruar** në Institucionin Publik Azili i Pleqve “Sju Rajder” në Manastir. Kjo vizitë u realizua në bashkëpunim me Shoqatën e Punonjësve Social të Qytetit të Shkupit dhe Shoqatën e Infermiereve, Mamive dhe Teknikëve të RM-së

Fillimisht, MPN-ja zhvilloi bisedë me ekipin profesional të këtij Institucioni, më pas zbatoi inspektim në kapacitetet e vendosjes dhe zhvilloi bisedë me një numër të madh të shfrytëzuesve të vendosur në këtë Azil. Në fund të vizitës u zhvillua bisedë me drejtorin e Institucionit, të cilit iu prezantuan perceptimet dhe konstatimet fillestare me paralajmërimin se për vizitën do të përgatitet dhe dërgohet raport i veçantë.

IP Azili i Pleqve “Sju Rajder” është ndërtuar në muajin maj të vitit 2014, konform standardeve evropiane për azilet e pleqve. Ky Institucion ka në dispozicion dy blloqe, njëri bllok u është dedikuar personave të palëvizshëm, ndërsa blloku tjetër u është dedikuar personave të moshuar të lëvizshëm. Varësisht nga gjendja shëndetësore e shfrytëzuesve, nevojat e tyre dhe gjendja materiale, në Institucion ekzistojnë çmime të ndryshme për përkujdesje, por shërbimet e oftruara janë me cilësi të njëjtë.

Gjatë vizitës së Azilit, MPN-ja bisedoi me disa shfrytëzues të cilët thanë se kanë kushte të mira për jetesë dhe, në përgjithësi janë të kënaqur me ushqimin të cilin e marrin në Institucion. Sipas numrit më të madh të shfrytëzuesve, ushqimi është i mirë dhe i shumëllojshëm, ndërsa njëherësh mbahet kujdes edhe për përkatësinë fetare. Megjithatë, për personat me diabet dhe sëmundje të tjera nuk ka regjim të posaçëm të ushqimit. Shfrytëzuesit e lëvizshëm potencuan se mund të dalin lirisht në rrethin e Azilit, por edhe jashtë tij, pa iu kufizuar e drejta themelore e lëvizjes së lirë.

Institucioni Publik Azili i Pleqve “Sju Rajder” në Manastir ka lidhur kontratë me një mjek-internist dhe një neurolog, të cilët së paku një herë në javë vijnë në Azil me qëllim që shfrytëzuesit të kenë mbrojtje shëndetësore të rregullt dhe në kohë. Numri më i madh i shfrytëzuesve kanë mjek amë dhe gjatë bisedës me MPN nuk paraqitën ankesa për kujdesin shëndetësor të cilin e marrin nga mjeku, përkatësisht shfrytëzuesit theksuan se mjeku vjen çdo ditë të mërkurë dhe ai hyn në të gjitha kapacitetet e vendosjes, i viziton dhe i pyet nëse kanë ndonjë problem shëndetësor. Në rastet kur shfrytëzuesit kanë nevojë për stomatolog, të njëjtët i dërgojnë në ordianca stomatologjike jashtë Azilit.

Për gjendjet e hasura, si dhe rekomandimet e dhëna u përgatit dhe u dërgua raport deri te Azili i Pleqve dhe deri te Ministria kompetente për Punë dhe Politikë Sociale.